

PROKURORIA E PËRGJITHSHMË
Nr. 68/9 Prot.
Datë 01.03.2021
DREJTORIA Kalineli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT KORÇË

Nr. 105 Prot

Korçë, më 26.02.2021

LËNDA: Dërgohet Raporti Vjetor 2020

DREJTUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME

TIRANË

Mbështetur në shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme nr. 68 date 14.01.2021 "Per paraqitjen e raportit vjetor 2020" bashkëlidhur po ju dërgojmë raportit vjetor 2020 mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit Korçë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTUESE E PROKURORISË

OLLGA VISI

ME POROSI DHE AUTORIZIM

PROKURORE

IRENA ÇUNOTI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANE GJYKATES SE APELIT
KORÇË

R A P O R T
MBI VEPRIMTARINË E PROKURORISË SË APELIT KORÇË
PËR PERIUDHËN 1 JANAR 2020 - 31 DHJETOR 2020

Z. OLSIAN CELA
PROKUROR I PËRGJITHSHËM I REPUBLIKËS

PROKURORIA E PËRGJITHSHME
T I R A N Ë

Në realizim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 50 të ligjit 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, parashtroj para Prokurorit të Përgjithshëm raportin vjetor të analizës së treguesve të punës mbi bazën e të dhënave statistikore, të angazhimeve dhe problematikave të konstatuara për vitin 2020.

Veprimtaria e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë me juridiksion të përgjithshëm, për vitin 2020 si objekt analize, në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe Konventave Ndërkombëtare është ushtruar në vazhdimësi për zbatimin me korrektësi të Ligjit Procedural dhe Material Penal, Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, duke treguar angazhim dhe përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve ligjore në lidhje me përfaqesimin e akuzës gjatë gjykimit në shkallë të dytë (në apel), veçanërisht për veprat penale kundër korrupsionit apo abuzimit me detyrën nga zyrtarët shtetërorë, krimit të organizuar dhe veprave penale me natyrë gjinore dhe diskriminuese, si dhe në procedimin penal ndaj të miturve, për respektimin dhe garantimin e të drejtave procedurale të të miturve në konflikt me ligjin, të miturve dëshmitarë dhe viktima të veprës penale.

Gjatë këtij viti, duke mbajtur në konsideratë maksimale zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave “Në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”, zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe të Rezolutës së Kuvendit dhe Planit të Veprimit “Për zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së datës 18.06.2020”, kemi synuar në mënyrë të vazhdueshme rritjen e standarteve të gjykimit me një përfaqësim cilësor dhe korrekt të prokurorit të apelit.

Në këtë kontekst, kërkimet e prokurorëve në apel janë në koherencë me zbatimin e rekomandimeve prioritare dhe kjo materializohet më së miri në qëndrimet për ashpërsimin e politikës penale lidhur me masat e sigurimit dhe dënimet për krime të rënda, si dhe zbatimin e dënimeve alternative për vepra penale dhe autorë me rrezikshmëri të ulët shoqërore, për gratë dhe të miturit në konflikt me ligjin.

Për vetë specifikën e ushtrimit të funksionit të prokurorit të Apelit, si prokurori gjyqësorë, veprimtari kjo që lidhet me një hetim paraprak të kryer nga Prokuroria

pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me juridiksion të përgjithshëm, por dhe me një gjykim dhe vendim të Gjykatës, qëndrimet e prokurorëve në apel për çështjet e gjykuara, në raport me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe vendimin e Gjykatës së Apelit, kanë krijuar një standart në luftën kundër kriminalitetit, i cili gjen pasqyrim tek të dhënat statistikore për vitin 2020.

Në analizën më poshtë, do të përqëndrohemi në probleme të rëndësishme që lidhen jo vetëm me qëndrimin e prokurorit të Apelit në raport me kërkimet e bëra nga prokurorët e shkallës së parë dhe qëndrimin e gjykatës, si edhe problemet e hetimit dhe gjykimet që janë evidentuar gjatë këtij viti me qëllim përmirësimit e mëtejshëm. Në vazhdim të këtij raportimi, fillimisht do të japim një paraqitje të volumit të çështjeve të perfaqesuara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë me juridiksion të përgjithshëm, për vitin 2020 dhe më pas disa probleme që kanë dalë gjatë gjykimet dhe shqyrtimit të çështjeve.

- **Volumi i çështjeve në tërësi të ndjekura nga Prokuroria e Apelit Korçë është si më poshtë:**

Për vitin 2020, në Prokurorinë e Apelit Korçë janë regjistruar në total 478 çështje nga të cilat 437 çështje të reja dhe 41 të mbartura nga viti 2019.

Çështjet e gjykuara dhe të përfunduara për vitin 2020 janë gjithsej 437 çështje penale me pjesëmarrjen e prokurorit të Apelit nga të cilat:

- 71 (shtatëdhjetë e një) çështje themeli,
- 289 (dyqind e tetëdhjetë e nëntë) masa sigurimi,
- 18 (tetëmbëdhjetë) shuarje masa sigurimi,
- 59 (pesëdhjetë e nëntë) çështje të veçanta (*me objekt ankim vendim mosfillimi, me viktimë akuzuese, në seancën paraprake, në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, lirim me kusht, etj.*)
- Janë mbartur për vitin 2021, 41 (dyzet e një) çështje (20 janë çështje themeli dhe 21 çështje të veçanta).

Duke krahasuar numrin e përgjithshëm të çështjeve të përfunduara në vitin 2020 (437 çështje), me vitin 2019 (*ku numri i përgjithshëm i çështjeve të përfunduara ka qënë 385 çështje*), rezulton se ka një rritje prej 52 çështjesh.

- **Volumi i çështjeve të ndara sipas prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, që janë në juridiksionin e Prokurorisë së Apelit Korçë:**

-Për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë janë shqyrtuar 57 çështje themeli nga të cilat 1 çështje mbi apelin e prokurorit dhe 117 raste mbi apelin e të pandehurit, si dhe janë shqyrtuar 173 çështje me objekt masa sigurimi personal, nga të cilat 3 mbi apelin e prokurorit.

-Për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec janë shqyrtuar 14 çështje themeli të gjykuara të gjitha mbi apelin e të pandehurve, si dhe janë shqyrtuar 116 çështje me objekt masa sigurimi personal, nga të cilat 15 mbi apelin e prokurorit.

-Në të dhënat statistikore nuk përfshihen 59 çështje të përfunduara, të cilat në i kategorizojmë të veçanta, pasi kjo kategori nuk është e parashikuar në formularët e miratuar. Këto lloj çështjesh zënë një përqindje të konsiderueshme në veprimtarinë e Prokurorisë së Apelit Korçë dhe që shpesh lidhen me problematikë delikate, siç janë ankimet në lidhje me vendimet e mosfillimit të procedimit penal, në fazën e ekzekutimit të vendimit penal, çështjet me akuzë private nga viktima akuzuese, çështje të seancës paraprake etj, të cilat shqyrtohen mbi apelin e palëve në proces.

Ngarkesa e çështjeve për prokurorët e apelit:

- **Prokurore Ollga Visi** ka përfaqësuar akuzën në apel në 179 çështje nga të cilat:
 - 30 (tridhjetë) çështje themeli të përfunduara;
 - 127 (njëqind e njëzet e shtatë) çështje me objekt masa sigurimi të përfunduar, (ka ushtruar rekurs në 6 raste);
 - 9 (nëntë) çështje me objekt shuarje mase sigurimi;
 - 22 (njëzet e dy) çështje të tjera të kategorizuara të veçanta të përfunduar;
 - 19 (nëntëmbëdhjetë) çështje të mbartura për vitin 2021 (nga këto 11 çështje themeli dhe 8 çështje të veçanta);
 - Ka nxjerrë 42 (dyzet e dy) urdhëra ekzekutimi për vendimet gjyqësore të Gjykatës së Apelit;
 - Nga data 24.02.2020 deri në datën 23.05.2020 ka ndjekur veprimtarinë e prokurorisë me cilësinë e drejtueses, nga data 24.05.2020 deri në datën 15.07.2020 ka ushtruar funksionin e prokurores së apelit dhe nga kjo datë e në vazhdim ka ndjekur veprimtarinë e prokurorisë me cilësinë e drejtueses bazuar në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

- **Prokurore Irena Çunoti** ka ushtruar funksionin e prokurores në apel prej datës 15.07.2020 dhe ka përfaqësuar akuzën në 113 çështje nga të cilat:
 - 18 (tetëmbëdhjetë) çështje themeli të përfunduara (ka ushtruar rekurs në 1 rast);
 - 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) çështje me objekt masa sigurimi të përfunduar (ka ushtruar rekurs në 2 raste);
 - 6 (gjashtë) çështje me objekt shuarje mase sigurimi;
 - 26 (njëzet e gjashtë) çështje të tjera të kategorizuara të veçanta (ka ushtruar rekurs në 1 rast);
 - 22 (njëzet e dy) çështje të mbartura për vitin 2021 (nga këto 9 çështje themeli dhe 13 çështje të veçanta);
 - Ka nxjerrë 20 (njëzet) urdhëra ekzekutimi për vendimet gjyqësore të Gjykatës së Apelit.

- **Prokurore Rozeta Qirjaqi** ka ushtruar funksionin deri në datë 15.07.2020 dhe ka përfaqësuar akuzën në 69 çështje nga të cilat:
 - 23 (njëzet e tre) çështje themeli të përfunduar (ka ushtruar rekurs në 2 raste);
 - 35 (tridhjetë e pesë) çështje me objekt masa sigurimi të përfunduar (ka ushtruar rekurs në 2 raste);
 - 3 (tre) çështje me objekt shuarje mase sigurimi;
 - 11 (njëmbëdhjetë) çështje të tjera të kategorizuara të veçanta të përfunduar;
 - Ka nxjerrë 20 (njëzet) urdhëra ekzekutimi për vendimet gjyqësore të Gjykatës së Apelit;

Më poshtë, po japim një analizë më të hollësishme të shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit Korçë me juridiksion të përgjithshëm, shkaqet e apelimeve të bëra, përkrahjes së tyre dhe mënyrës së përfundimit.

1. ANALIZA MBI TREGUESIT STATISTIKORË PËR ÇËSHJTJET E THEMELIT:

Për çështjet e themelit të shqyrtuara gjatë vitit 2020 është përfaqësuar akuza në Gjykatën e Apelit Korçë në **71 (shtatëdhjetë e një)** çështje, me 132 të pandehur, nga të cilët 93 të arrestuar.

- ✓ Në **18** (tetëmbëdhjetë) çështje, për të cilat është kërkuar **mospranim ankimi**, nga gjykata është vendosur në 18 raste mospranim ankimi (*në këto raste çështjet janë apeluar nga të pandehurit dhe është disponuar me mospranim ankimi për shkak të heqjes dorë prej tyre nga ankimi në seancë gjyqësore, në kushtet kur ankimi ka ngelur pa objekt, apo nuk janë respektuar dispozitat për formën dhe afatin e ankimit*).
- ✓ Në **47** (dyzet e shtatë) raste, për të cilat prokurori i apelit ka kërkuar **lënie në fuqi** të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, nga Gjykata e Apelit është disponuar: në 37 raste për lënie në fuqi; në 9 raste është lehtësuar pozita e të pandehurit; në 1 rast është prishur vendimi dhe kthyer çështja për rigjykim.
- ✓ Në **2** (dy) raste, ku është kërkuar nga prokurori i apelit ndryshimi i vendimit dhe **rëndimi i pozitës** së të pandehurit, Gjykata e Apelit në 2 raste ka vendosur lënie në fuqi.
- ✓ Në **2** (dy) raste, ku është kërkuar nga prokurori i apelit ndryshimi i vendimit dhe **lehtësim i pozitës** së të pandehurit, nga Gjykata e Apelit në të 2 rastet ka lehtësuar pozitën e të pandehurit, duke pranuar kërkimin e prokurorit, (*bëhet fjalë për vepra penale dhe për persona me rrezikshmëri të ulët shoqërore duke zbutur masën e dënimit dhe aplikimin e alternativave të dënimit me burgim*).
- ✓ Në **2** (dy) raste, ku është kërkuar nga prokurori i apelit **prishje vendimi dhe kthimi i akteve për rigjykim**, nga Gjykata e Apelit në 1 rast është vendosur lënie në fuqi të vendimit dhe në 1 rast është vendosur prishje vendimi dhe kthim i çështjes për rigjykim.

Analizë mbi apelet e ushtruara nga Prokuroria e Shkallës së Parë për çështjet e themelit:

Për vitin 2020 janë gjykuar mbi ankimin e prokurorit **3** (tre) çështje, (*nga 22 çështje të gjykuara në vitin 2019*), ku sipas rretheve gjyqësore të **3** (tre) çështjet i përkasin Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë. Qëndrimi i prokurorit të apelit në përgjithësi ka qënë në mbështetje të ankimit të prokurorit të shkallës së parë dhe nuk ka heqje dorë nga ankimi, ku në **1** (një) rast është kërkohe pafajësi; në **1** (një) rast është kërkuar ndryshim kualifikimi; ndërsa në **1** (një) rast prokurori i shkallës së parë ka kërkuar lehtësim pozite të të pandehurit.

Nga **3** (tre) rastet e përkrahura të ankimit të prokurorëve, nga prokurori i apelit për çështjet e themelit rezulton se Gjykata e Apelit nuk ka pranuar asnjë prej tyre, por ka disponuar me lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

➤ ***Apele të ushtruara nga prokurori për vendime pafajësie:***

Është shqyrtuar 1 (një) çështje mbi apelin e prokurorit për vendim pafajësie të Gjykatës së Shkallës së Parë, nga të cilat:

- Në këtë rast, Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar apelin e prokurorit për prishje kthim dhe rigjykim të çështjes, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, për pafajësi të të pandehurës V.B akuzuar për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 të K.Penal. Për këtë rast nuk është ushtruar rekurs pasi nuk kanë ekzistuar shkaqe ligjore të parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale.

➤ ***Apel të ushtruar nga prokurori, për vendim me ndryshim të kualifikimit ligjor të veprës penale.***

Është shqyrtuar 1 (një) rast mbi apelin e prokurorit, për ndryshim të kualifikimit ligjor të veprës penale, në ngarkim të të pandehurit G.Z akuzuar për veprën penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur, parashikuar nga neni 103/1 i K.Penal.

- Në këtë rast nga prokurori i apelit është mbështetur apeli për ndryshimin e kualifikimit ligjor, ndërsa Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për deklarimin fajtor të të pandehurit.

➤ ***Apele të ushtruara nga prokurori, për llojin e masës së dënimit***

Është shqyrtuar 1 (një) rast mbi apelin e prokurorit, për ndryshim vendimi në lidhje me llojin dhe masën e dënimit, duke kërkuar ashpërsimin e masës së dënimit.

- Në këtë rast është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, i apeluar nga prokurori për masë dënimi duke mos pranuar kërkesën e prokurorit të apelit për ashpërsim dënimi, në ngarkim të të pandehurit A.Rr, akuzuar për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal.

Analizë mbi apelet e të pandehurve dhe lehtësimin e pozitës së të pandehurit vendosur nga gjykata:

- Në 101 (njëqind e një) çështje të apeluara nga të pandehurit, Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë duke rrëzuar kërkimin e tyre për lehtësim të pozitës.
 - Në 2 (dy) raste Gjykata e Apelit ka vendosur lehtësim të pozitës, me zbutje dënimi.
 - Në 1 (një) rast nga Gjykata e Apelit është ndryshuar vendimi dhe është disponuar për prishjen e vendimit dhe kthim çështje për rigjykim.
 - Në 1 (një) rast nga Gjykata e Apelit ka disponuar për lehtësim të pozitës së të pandehurit mbi kërkesën e prokurorit për neni 59 K.Penal.
- Gjatë shqyrtimit të çështjeve të themelit, Prokuroria e Apelit Korçë ka pasur pikësynim paraqitjen me cilësi të konkluzioneve, si në rastet kur është kërkuar lënie në fuqi të vendimit, por sidomos në çështjet ku është dhënë pafajësi dhe është argumentuar e kundërta, apo edhe në rastet kur është kërkuar ndryshim i kualifikimit ligjor. Në përgjithësi, apelet e ushtruara nga Prokuroritë e Shkallës së Parë kanë qënë ligjore dhe janë mbështetur nga ana jonë, por ka vënd për

përmirësim, kjo pasi shpesh herë, apelet janë bërë objekt i diskutimit me prokuroret, pasi konstatohen problematika për mënyrën e formulimit, shkaqet e ankimit në kundërshtim të vendimit të Gjykatës, si dhe për të plotësuar apelin sipas nenit 415 të K.Pr.Penale, sepse konstatohet që apeli ushtrohet nga prokuroret pa u njohur me arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë. Plotësimi i kësaj kërkesë bëhet imediate referuar përcaktimeve të nenit 425 të K.Pr.Penale me titull “Kufijtë e shqyrtimit të çështjes” si dhe të nenit 426/a/6 të K.Pr.Penale, ku përcaktohet se Gjykata e Apelit shqyrton çështjen brënda shkaqeve të ngritura në ankim dhe palët nuk mund të parashtojnë në seancë shkaqe tej atyre të ngritura në apel. Për apelet që ushtrojnë prokurorët për pafajësi duhet të mbahet parasysh neni 427 i K.Pr.Penale, ku prokurorët në aktin e apelit të pasqyrojnë edhe kërkimin për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Vlen të përmendet fakti, se përpos numrit të ulët të apeleve të prokurorit, nuk konstatohet ushtrimi i apeleve kundërshtuese nga prokurorët në referim të nenit 423 të K.Pr.Penale.

- Bazuar në rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm konstatohen në apel kërkesa të pakta të prokurorisë për gjykime të drejtpërdrejta, sidomos për çështjet ku hetimi përfundon brenda kohës së “Arrestit në flagrance” dhe lidhet me çështje fakti, apo gjykimi me marrëveshje dhe urdhri penal si institute të reja në procesin penal.
- Prokuroret e Apelit kanë respektuar afatet ligjore të gjykimit të çështjes duke mos u bërë pengesë në asnjë rast, për shtyrjen e procesit gjyqësor në Gjykatën e Apelit.
- Aplikimi i alternativave të dënimit duhet parë me përparësi kur janë kushtet dhe kriteret sipas dispozitave të posaçme (nenet 53/a, 59, 63, etj) dhe për vepra penale dhe autorë me rrezikshmëri të ulët shoqërore. Kjo vjen edhe si kërkesë e kohës në zbatim të Rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, por dhe standarteve ndërkombëtare.
- Ndryshe trajtohen personat shoqërisht të rrezikshëm, përsëritës në krim apo persona që kryejnë vepra penale për të cilat shoqëria është e ndjeshme (*duke përmendur dhunën në familje, krimet kundër personit veçanërisht vrasjet, veprat penale që lidhen me trafikim të lëndëve narkotike, trafikimi i qënieve njerëzore, korrupsioni, krimi ekonomik etj*). Apelet e ushtruara nga prokurorët për këto vepra penale mbështeten, por edhe në rastet kur nga gjykata është lehtësuar pozita e të pandehurit me ulje të dënimit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.
- Në rastet kur subjekti është i mitur, një rëndësi të veçantë merr zbatimi i masave alternative për shmangien nga ndjekja penale të të miturit të përcaktuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, ku një rol kyç për këtë qëllim përcakton dhe prania e aktoreve të tjerë në shërbim të dhënies së drejtësisë apo dhe interesit më të lartë të fëmijës, veç subjekteve proceduriale prokurori dhe gjykatë, duke respektuar të drejtat proceduriale të të miturit viktimë, të miturit në konflikt me ligjin dhe të miturit dëshmitar, si dhe për të krijuar një standart për një proces të rregullt ligjor. Gjithashtu, për të patur efektivitet në lidhje me çështjet penale me të mitur në konflikt me ligjin mendoj se duhet të krijohet një sistem të dhënash statistikore të veçanta, me

qellim për te krijuar një politikë penale të unifikuar në raport me kategorinë e veprave penale dhe moshën e subjekteve të mitur në konflikt me ligjin.

II. ANALIZA E TREGUESVE MBI ÇËSHTJET ME OBJEKT ÇAKTIM MASE SIGURIMI.

Viti 2020 ka pasur një rritje të përfaqësimit të çështjeve me objekt masa sigurimi. Këtë vit, janë regjistruar **289** (dyqind e tetëdhjetë e nëntë) masa sigurimi, nga **158** (njëqind e pesëdhjetë) që janë regjistruar në vitin 2019.

Janë shqyrtuar dhe përfunduar gjithësej **289** (dyqind e tetëdhjetë e nëntë) masa sigurimi.

Masat e sigurimit në **18** (tetëmbëdhjetë) raste, janë shqyrtuar mbi apelin e prokurorit dhe në **271** (dyqind e shtatëdhjetë e një) raste mbi apelin e personave nën hetim.

- ✓ Në **18** (tetëmbëdhjetë) raste është kërkuar nga prokurori i shkallës së parë ndryshim i masës së sigurimit, për rëndim masë sigurimi “Arrest në burg”.
- ✓ Në **10** (dhjetë) raste është pranuar apeli i prokurorit nga prokurori i apelit dhe ne **8** (tetë) raste prokurori i apelit ka hequr dorë nga apeli i prokurorit të rrethit.

- Ne **1** (një) rast çështja ka ardhur mbi apelin e prokurorit të shkallës së parë Pogradec, për personat nën hetim G.J për veprat penale “Kontrabande me mallra që paguhen aksize” dhe “Kontrabande me mallra të tjera” parashikuar nga neni 172 dhe 174 i K.Penal, dhe për shtetasin V.B për veprën penale të “Kontrabandës nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore” parashikuar nga neni 175 i K.Penal.

Ne këtë rast prokurori i Apelit ka hequr dorë nga apeli i prokurorit duke e konsideruar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të marrë në zbatim të drejtë të dispozitave procedurale të K.Pr.Penale. Pasi në rastin konkret personat ishin me rrezikshmëri të ulët shoqërore, si dhe sasia e mallit të futur kontrabante ishte relativisht e ulët pasi sipas shkreses me nr. 1251/1 prot, dt. 17.12.2020 lëshuar nga Dega Doganore Pogradec rezultoi se vlera e detyrimeve doganore për të katër artikujt të futur kontrabante kapte vlerën 18.287 lekë.

- Në **1** (një) rast çështja ka ardhur mbi apelin e prokurorit të Shkallës së Parë Pogradec për shtetasin nën hetim E.H i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Dhunës në familje”, parashikuar nga neni 130/a/3 i K.Penal, i cili në kërkesën e paraqitur në gjykatë ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

Ne seancë gjyqësore kjo çështje është përfaqësuar nga një prokuror tjetër i cili ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “Shttrim të perkohshëm në një spital psikiatrik”, parashikuar nga nenet 232 germa “e” dhe 239 të K.Pr.Penale.

Sipas kërkeses së prokurorit ka vendosur dhe gjykata. Vendim i Gjykatës është apeluar nga prokurori që ka paraqitur kërkesën në gjykatë, dhe jo nga prokurori i cili ka marrë pjesë në gjykim. Shkaqet e parashtruara në ankim nga prokurori nuk kanë qenë ligjore dhe për rrjedhojë nuk e bënin të cënueshëm vendimin objekt ankimi. Pasi ai nuk legjitimohet të ushtrojë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit Korçë, për shkak se nuk ka qenë prokurori i cili

ka marrë pjesë në gjykim referuar nenit 420/1 gërma “a” i K.Pr.Penale. Në këto rrethana prokurori i Apelit nuk e ka përkrahur ankimin e prokurorit, duke hequr dore për shkak se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është konsideruar i drejtë dhe i bazuar në ligj.

- Në çështjen penale në ngarkim të shtetasve nën hetim M.B, etj për veprat penale të “Mbajtje pa leje, prodhim i armeve, armëve shpërthyesë dhe municionit” parashikuar nga neni 278/2 dhe “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të flohta” parashikuar nga neni 279 të K.Penal ndonëse seanca gjyqësore ka qënë me objekt: Vlefesim arresti në flagrancë dhe caktim mase sigurimi “arrest në burg” për të tre këta shtetas, ankimi i prokurorit ka qënë vetëm përsa i përket shpalljes të moskompetencës tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente e konkretisht Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.
Në këtë çështje, ku masat e sigurimit personal “arrest në burg” për të tre shtetasit nën hetim i kishte vendosur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe për to nuk ishte ushtruar ankim, prokurori i Apelit ka hequr dorë nga ankimi i prokurorit Pogradec për moskompetencën, për shkak se vepra penale ishte kryer në Tiranë.
- Në 1 (një) rast çështja ka ardhur mbi apelin e prokurorit të Prokurorisë së Shkallës së Parë Pogradec, për personin nën hetim I.B për veprat penale “Mbajtje pa leje, prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit” parashikuar nga neni 278/1 dhe 278/3 i K.Penal, pasi në vendimin gjyqësor të Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, ndaj këtij shtetasi nën hetim ishte vendosur masë sigurimi “arrest në burg” me afat 30 ditor, dhe prokurori i çështjes kërkonte vendosjen e masës së sigurimit “arrest në burg” pa afat.
Në këtë rast prokurori i Apelit ka hequr dorë nga apeli i prokurorit për faktin se masa e sigurimit “arrest në burg” me afat 30 ditor ishte plotësuar nga shtetasi nën hetim I.B (gjatë kohës që çështja shqyrtohet në Gjykatën e Apelit Korçë) dhe objekti i këtij ankimi ishte zgjidhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, e cila me vendimin e saj kishte caktuar ndaj shtetasit nën hetim I.B masën e sigurimit “arrest në burg” pa afat, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.
- Po kështu në një çështje tjetër penale po të Prokurorisë së Shkallës së Parë Pogradec në ngarkim të shtetasit nën hetim S.R (me detyrë noter), prokurori i çështjes ka kërkuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec vendosjen e masës së sigurimit personal “arrest shtëpie” ndaj shtetasit të lartpërmendur, ku kjo e fundit ka vendosur rrëzimin e kërkesës të prokurorit të çështjes.
Këtë vendim e ka apeluar prokurori i çështjes, por prokurori i Apelit ka hequr dorë nga ky ankim pasi nuk ishin përpara kushteve dhe kritereve të vendosjes të masave të sigurimit parashikuar nga nenet 228 dhe 229 të K.Pr.Penale, nuk ekzistonte dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi nën hetim S.R të kishte kryer veprën penale “Shpërdorim detyrë” parashikuar nga neni 248 i K.Penal, nuk kishte prova që ai kishte ndikuar tek vullneti i palëve për të përpiluar deklaratën përkatëse, nuk ishte bërë asnjë veprim shtrengimi midis palëve para noterit, noteri kishte kryer detyrën e tij duke përpiluar deklaratën përkatëse, etj.
- Në çështjen penale në ngarkim të shtetasit nën hetim R.H për veprën penale “Drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 i

K.Penal, Gjykata e Shkallës së Parë Korçë pasi ka vlerësuar arrestin e flagrancës, ka caktuar masën e sigurimit personal ndaj tij, atë të “Detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale. Kjo masë siguri nga ana e prokurorit të çështjes është apeluar, ku ndonëse në apelin e tij parashtronte një sërë shkaqesh në kundërshtim me vendimin gjyqësor në lidhje me papërshtatshmërinë e masës së sigurimit të vendosur nga gjykata, në ankimin e tij kërkonte ndryshimin e vendimit gjyqësor për masën e sigurimit, por nuk konkludonte se çfarë mase siguri personal kërkonte konkretisht për shtetasin R.H.

Prokurori i Apelit edhe në këtë rast ka hequr dorë nga ankimi i prokurorit të çështjes pasi masa e sigurimit personal e vendosur ndaj shtetasit nën hetim R.H nga Gjykata e Shkallës së Parë Korçë ishte një mase e drejtë në përputhje me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe të autorit, me shkallën e nevojave të sigurimit, me faktin se personi nën hetim ishte i padënuar më parë, etj.

- ✓ Në 20 (njëzet) raste është kërkuar nga prokurori i Apelit ndryshim i masës së sigurimit, nga të cilat 8 (tetë) raste (*mbi apelin e prokurorit*) për masë më të rëndë siguri “Arrest në burg” dhe 12 (dymbëdhjetë) raste për masë më të butë siguri (*mbi apelin e të pandehurit*). Në 4 (katër) raste është pranuar apli i prokurorit, duke vendosur Gjykata e Apelit “Arrest në burg”, në 11 (njëmbëdhjetë) raste është vendosur masë më e butë siguri, ndërsa në 5 (pesë) raste është miratuar vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë.
- ✓ Në 24 (njëzet e katër) raste, mbi ankimin e të pandehurit, është disponuar me mospranim ankimi për shkak të heqjes dorë nga ankimi.
- ✓ Në 245 (dyqind e dyzet e pesë) raste është kërkuar nga prokurori i apelit miratim vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë, ku nga Gjykata e Apelit në 185 (njëqind e tetëdhjetë e pesë) raste është vendosur miratim vendimi; në 60 (gjashtëdhjetë) raste është ndryshuar masa e sigurimit “Arrest në burg” me një masë siguri më të bute. Vlen të theksohet se nuk ka disponim nga Gjykata e Apelit për shfuqizim vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë. Për 12 (dymbëdhjetë) raste kur është konstatuar zbatim i gabuar i ligjit është ushtruar rekurs.
- Në gjykimet me këtë objekt, Prokuroria e Apelit Korçë orientohet në zbatimin me korrektësi jo vetëm të nenit 228 e 229 të K.Pr.Penale, por sidomos të kërkesave të nenit 230 të K.Pr.Penale, lidhur me kriteret e veçanta të “Arrestit në burg”. Megjithatë duhet të tregohet kujdes në aplikimin e kësaj mase siguri.
- Në respektim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe siç rekomandon Këshilli i Ministrave, kërkesa për masën e sigurimit “Arrest në burg” për të miturit, të jetë rast përjashtimor dhe në rastet kur ajo kërkohet/vendoset, duhet që hetimet të përfundojnë në kohën më të shkurtër të mundshme; Ashpërsim të masës së sigurimit/dënimit ndaj personave me rrezikshmëri të madhe shoqërore dhe për vepra penale që parashikojnë masë dënimi në minimum mbi 5 vjet burgim;
- Krahas llojeve të tjera të masave të sigurimit në veçanti konstatohet zbatimi i masës së sigurimit “Garanci pasurore” nga gjykata. Garancia pasurore sipas nenit 236/1 i K.Pr.Penale, e kushtëzon zëvendësimin e masës arrest në burg

ose në shtëpi kur është vendosur vetëm për shkak të ekzistencës së rrezikut të ikjes. Gjithsesi kostatohen raste ku Gjykata e Apelit ka zëvendësuar “arrestin në burg” me “garanci pasurore” edhe pse kanë ekzistuar shkaqe të tjera të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provave, apo rreziku i përsëritjes së veprës penale. Këto raste janë bërë objekt rekursi për zbatim të gabuar të ligjit.

- Masat e sigurimit për të cilat janë ushtruar 10 (dhjetë) rekurse kanë qënë për veprat penale të parashikuar nga nenet 175, 186/a/2, 248 të K.Penal (në një rast), për nenet 298/2 (në tre raste) dhe 298/3 (në gjashtë raste) të K.Penal, ku nga ana e gjykatës për 6 persona nën hetim është ndryshuar masa e sigurimit, duke u caktuar masë sigurimi “garanci pasurore” parashikuar nga neni 236/1 i K.Pr.Penale, për 3 persona nën hetim është ndryshuar masa e sigurimit, duke u caktuar masë sigurimi “arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale dhe për 3 persona nën hetim është ndryshuar masa e sigurimit, duke u caktuar masë sigurimi “detyrim për paraqitje” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.

III. ANALIZË MBI ÇËSHTJET E KATEGORIZUARA TE VEÇANTA:

Për vitin 2020 janë përfunduar **59** (pesëdhjetë e nëntë) çështje të kategorizuara të veçanta ku përfshihen çështje penale me objekt vendimi mosfillimi, lirim me kusht, çështje që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimit etj, si dhe çështjet me viktime akuzuese, nga të cilat **14** (katërbëdhjetë) çështje mbi apelin e prokurorit dhe **45** (dyzet e pesë) mbi apelin e të pandehurit ose kërkesa të palëve në proces. Për çështjet me këtë objekt është ushtruar **1** (një) rekurs për zbatim të gabuar të ligjit.(L.B)

➤ Analizë për çështjet e veçanta mbi apelin e prokurorit:

- ✓ Në **4** (katër) raste është përkrahur ankimi i prokurorit nga prokurori i apelit, ku në **1** (një) rast Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e ankimuar sipas apelit të prokurorit dhe në **3** (tre) raste ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Në **1** (një) apel të pranuar të prokurorit, bëhet fjalë për çështje me objekt ankim kundër vendimit të mosfillimit duke ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe duke lënë në fuqi vendimin e mosfillimit të prokurorit.
- ✓ Në **3** (tre) raste me objekt ankim kundër vendimit të mosfillimit nuk është përkrahur ankimi i prokurorit, duke hequr dorë prokurori i apelit, për shkak se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është konsideruar i drejtë dhe i bazuar në ligj, pasi nuk kanë ekzistuar rrethana për mosfillimin e procedimit duke urdheruar rregjistrimin e tij.
- ✓ Në **2** (dy) raste me objekt ankim kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq nuk është përkrahur ankimi i prokurorit, duke hequr dorë prokurori i apelit, për shkak se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë është konsideruar i drejtë dhe i bazuar në ligj. Njëra i përket çështjes penale në ngarkim të të pandehurës E.L, akuzuar për veprën penale të “Dhunës në familje” parashikuar nga neni 130/a/3 i K.Penal, ku Gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur të mos pranojë kërkesën për dërgimin për gjykim, duke ia kthyer aktet prokurorit, për shkak se ka çmuar se cilësimi juridik i veprës i bërë nga prokurori ishte i gabuar. Vepra penale nuk duhet të kualifikohet në

“Dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a/3 i Kodit Penal, por në “Plagosje e lehte me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, pasi e pandehura me viktimen, nuk konsiderohen subjekte të kësaj vepre penale, duke mos u gjetur i drejtë pretendimi e arsyetimi i prokurorit se ato, pra e pandehura me bashkëjetuesen e djalit të saj mund të jenë subjekte të veprës penale të “Dhunës në familje”.

Për sa i përket zgjidhjes së çështjes për kthimin e akteve prokurorit, në rastin konkret konsideroj të drejtë vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, përderisa prokurori i çështjes nuk ka vepruar sipas orientimit të gjykatës për të bërë ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale në seance gjyqësore nga vepra penale e “Dhunës në familje”, parashikuar nga neni 130/a/3 i K.Penal në veprën penale të “Plagosjes së lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i K.Penal.

- ✓ Në 1 (një) rast me objekt ankim kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq nuk është përkrahur ankimi i prokurorit, duke hequr dorë prokurori i apelit, për shkak se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec është konsideruar i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Kjo çështje i përket të pandehurit I.H, i akuzuar për veprën penale “Fshehjes së të ardhurave”, parashikuar nga neni 180 i K.Penal. Gjykata ka vendosur pushimin e çështjes në ngakim të të pandehurit në bazë të nenit 328/1/b të K.Pr.Penale dhe jo kalimin e çështjes për gjykim, pasi nga provat e administruara në dosje konstatohet se nuk ndodhemi para veprës penale për të cilën organi i akuzës e ka akuzuar të pandehurin.

- ✓ Në 1 (një) rast me kërkuar të dënuar L.B, i dënuar për kryerjen e veprës penale “Trafikim i narkotikëve” parashikuar nga neni 283/a/2-22 i K.Penal, me objekt “Lirim me kusht”, Gjykata e Shkallës së Parë Korçë ka vendosur rrezimin e kërkesës të tij. Kërkuar ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Korçë ku kjo e fundit ka pranuar kërkesën e tij dhe e ka liruar të denurin L.B para kohe me kusht për pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit.

Qëndrimi i prokurorit të Apelit për këtë çështje ka qënë për lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe më pas ka paraqitur rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë, pasi i dënuari L.B nuk plotesonte kushtet dhe kriteret e parashikuara nga neni 64 të K.Penal.

- ✓ Në 2 (dy) raste me objekt ankim kundër vendimit të mosfillimit, mbi kërkimin e prokurorit të apelit është disponuar nga Gjykata e Apelit me mospranim ankimi të prokurorit, për shkak se ankimi është paraqitur jashtë afatit ligjor 10 ditore (neni 290, pika 2 i K.Pr.Penale).

➤ **Analizë për çështjet e veçanta me apel të palëve në proces:**

- Nga këto janë gjykuar 8 (tetë) raste me objekt “Lirim me kusht”, ku mbi kërkimin e prokurorit për lënie në fuqi të vendimit, në 3 (tre) raste Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe është ushtruar rekurs për shkelje të ligjit.

Çështjet me objekt “Lirim me kusht”, bazuar në nenin 64 të K.Penal, janë të shpeshta në Gjykatën e Apelit, kryesisht të apeluara nga të dënuarit.

Në këtë lloj gjykimesh, prokurorët janë treguar të kujdesshëm jo vetëm në respektim të kërkesave të nenit 64 të K.Penal, por edhe në respektim të vendimit unifikues Nr. 2, Datë 25.05.2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të vendosur për këtë

objekt. Për rastet kur Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë në zbatim të gabuar të ligjit, nga ana jonë është ushtruar rekurs.

- Për çështjet me objekt "*Ankim kundër vendimit të mosfillimit*" janë gjykuar 24 (njëzet e katër) çështje, nga këto 10 (dhjetë) raste janë lënë në fuqi; 5 (pesë) çështje është disponuar me mospranim ankimi; dhe në 6 (gjashtë) raste Gjykata e Apelit ka disponuar për ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe urdhërimin e regjistrimit të proçedimit penal.

Në 7 (shtatë) çështjet me ankim të prokurorit të shkallës së parë, rezultoi se Gjykata e Apelit Korçë ka disponuar me 4 (katër) çështje lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, duke mos e pranuar kërkesën e prokurorit të apelit; 1 (një) çështje e ka pranuar kërkesën e prokurorit të apelit dhe në dy çështje Gjykata e Apelit ka disponuar me mospranim ankimi.

Në çështjet me objekt "*Ankim kundër vendimit të mosfillimit*", kemi vlerësuar shkaqet ligjore nëse duhet të vendoset regjistrimi i proçedimit penal nga prokurori apo jemi para kushteve ligjore të mosfillimit të proçedimit në kuptim të nenit 290 të K.Pr.Penale. Gjithashtu, janë kontrolluar vendimet e mosfillimit në respektim të afateve ligjore detyruese të përcaktuara në K.Pr.Penale që lidhen me marrjen e vendimit të mosfillimit nga prokurori, njoftimin e personave që legjitimohen të ushtrojnë të drejtën e ankimit dhe afatin e tij.

- Për çështjet me viktimë akuzuese janë gjykuar 3 (tre) raste, ku në 1 (një) rast është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë dhe në 2 (dy) raste është vendosur nga Gjykata e Apelit mospranim ankimi.

Çështjet që lidhen "*me viktimën akuzuese*", proçesi është orientuar sipas nenit 59 të K.Pr.Penale dhe prokurori ka ushtruar funksionin brenda kufijve të parashikuara nga kjo dispozitë, por gjithmonë me një rol aktiv në respektim të parimit të ligjshmërisë për të dhënë mendim, lidhur me fajësinë e të akuzuarit, me vlerësimin e provave të paraqitura nga palet në proçes, apo dhe me dhënien e mendimit për masën e dënimit.

- Në 23 (njëzet e tre) raste çështjet janë shqyrtuar me objekte të ndryshëm kryesisht me kërkesa në fazën e ekzekutimit, mbarim i afateve të paraburgimit, bashkim dënimesh, shtyrje ekzekutim dënimi, shuarje mase, etj.
- Në çështjet me objekt "*Ankim kundër vendimit të pushimit*" ku hetimi paraprak kontrollohet nga gjykata, me ndryshimet në K.Pr.Penale ato zgjidhen në Gjykatën e Apelit në dhomën e këshillimit.

IV. ANALIZË SIPAS KATEGORISË SË VEPRAVE PENALE NË ZBATIM TË REKOMANDIMEVE PËR VITIN 2020 NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT:

I. Lidhur me veprat penale kundër korrupsionit informojmë se për periudhën Janar - Dhjetor 2020, janë regjistruar 3 (tre) çështje themeli, ardhur nga Gjykata e Shkallës së Parë.

- **Për veprën penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*"**, parashikuar nga neni 259 i K.Penal janë gjykuar 2 (dy) çështje. Një (1) çështje në ngarkim të të pandehurit E.G, për të cilin Gjykata e Shkallës së Parë Korçë ka disponuar me fajësi. Çështja ka ardhur mbi apelin e të pandehurit për zbutje dënimi, prokurori i apelit ka kërkuar lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me

lënie në fuqi të vendimit. Në rastin tjetër me të pandehur V.B, Gjykata e Shkallës së Parë Korçë ka disponuar me pafajësi. Çështja ka ardhur mbi apelin e prokurorit, prokurori i apelit ka kërkuar prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për rigjykim, ndërsa Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

- **Për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”** të parashikuar nga neni 248 i K.Penal, është gjykuar 1 (një) çështje me 2 të pandehur. Çështja ka ardhur mbi apelin e të pandehurve dhe mbi kërkimin e prokurorit të apelit për lënie në fuqi të vendimit, Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi.

II. Lidhur me veprat penale kundër narkotikeve informojmë se për periudhën Janar - Dhjetor 2020, janë gjykuar 8 (tetë) çështje themeli, si më poshtë:

- **Për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”**, parashikuar nga Neni 283/1 i K.Penal, janë gjykuar 3 (tre) çështje me 4 të pandehur, të katërt me masë sigurimi “Arrest në burg”. Në 3 (tre) raste çështja ka ardhur mbi apelin e të pandehurve për zbutje dënimi. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit për 3 (tre) raste për lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, në një rast Gjykata e Apelit ka disponuar me lehtësim të pozitës të të dënuarit dhe në 2 (dy) çështjet e tjera ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Kryesisht në këto çështje për nenin 283/1 i K.Penal bëhet fjalë për sasira të vogla të lëndës narkotike, në formën e mbajtjes në kundërshtim me ligjin dhe me qëllim përdorimi vetjak.
- **Për veprën penale “Trafikim i narkotikëve”, në bashkëpunim**, parashikuar nga Neni 283/a/2 i K.Penal, është gjykuar 1 (një) çështje me 4 të pandehur, të 4 me masën e sigurimit “Arrest në burg”. Këto çështje kanë ardhur mbi apelin e 3 të pandehurve, kryesisht për zbutjen e masës së dënimit. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit për lënie në fuqi, Gjykata e Apelit ka disponuar për lënie në fuqi të vendimit në këto tre raste, duke mospranuar apelin e të pandehurve për lehtësimin e pozitës.
- **Për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, në bashkëpunim**, parashikuar nga Neni 283/2 i K.Penal, janë gjykuar 2 (dy) çështje me 5 të pandehur, me masën e sigurimit “Arrest në burg”. Një çështje ka ardhur mbi apelin e të pandehurve, për zbutjen e masës së dënimit dhe 1 (një) çështje me apelin e prokurorit për ashpërsim dënimi. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit për lënie në fuqi, për një çështje, Gjykata e Apelit ka disponuar për lënie në fuqi të vendimit, duke mos pranuar apelin e të pandehurve për lehtësimin e pozitës. Çështja tjetër që ka ardhur mbi apelin e prokurorit është mbështetur nga prokurori i apelit, kurse Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.
- **Për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”**, parashikuar nga Neni 284/2 i K.Penal, është gjykuar 1 (një) çështje me 13 të pandehur, të arrestuar. Çështja vjen mbi apelin e 4 të pandehurve për zbutje të dënimit, ku prokurori i apelit ka kërkuar lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit ka disponuar për lënie në fuqi të vendimit.

- **Për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”**, parashikuar nga Neni 284/1 i K.Penal, është gjykuar 1 (një) çështje me 1 të pandehur. Çështja vjen mbi apelin e të pandehurit për aplikimin e nenit 59 të K.Penal dhe prokurori i apelit ka kërkuar lehtësim të pozitës duke aplikuar nenin 59 të K.Penal dhe Gjykata e Apelit ka disponuar për pranim të kërkesës së prokurorit të apelit duke aplikuar nenin 59 të K.Penal.
- **Lidhur me çështjet e përfunduara për Masat e Sigurimit janë këto të dhëna:**
 - **Për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”** parashikuar nga neni 283/1 të K.Penal; janë gjykuar 12 (dymbëdhjetë) çështje me objekt masa sigurimi, 10 (dhjetë) mbi apelin e të pandehurve dhe 2 (dy) mbi apelin e prokurorit për ndryshim mase sigurimi duke rënduar pozitën dhe Gjykata e Apelit ka pranuar të 2 (dy) apelet e prokurorit duke disponuar me rëndimin e pozitës të shtetasve nën hetim. Prokurori i Apelit ka kërkuar miratimin e vendimit për 9 (nëntë) raste, kurse Gjykata e Apelit në 6 (gjashtë) raste ka pranuar kërkesën e prokurorit për miratim vendimi, në 3 (tre) raste ka disponuar me ndryshimin e vendimit, duke zbutur llojin e masës së sigurimit nga “Arrest në burg” në një masë më të lehtë sigurimi. Per 1 (një) rast prokurori ka kërkuar lehtësimin e pozitës të shtetasit nën hetim dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me pranimin e kërkesës së prokurorit të apelit duke lehtësuar pozitën.
 - **Për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve” në bashkëpunim**, parashikuar nga neni 283/a/1 të K.Penal; janë gjykuar 2 (dy) çështje masa sigurimi mbi apelin e 2 të pandehurve. Prokurori i apelit ka kërkuar miratim vendimi në 2 raste dhe Gjykata e Apelit në të dyja raste ka miratuar kërkesën e prokurorit. Nje prej këtyre rasteve ka objekt caktim masë sigurimi për qëllime ekstradimi, në ngarkim të shtetasit nën hetim R.D (R.Xh), akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 28/a i K.Austriak.
 - **Për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” në bashkëpunim**, parashikuar nga neni 283/2 të K.Penal; janë gjykuar 15 (pesëmbëdhjetë) çështje masa sigurimi mbi apelin e 15 të pandehurve. Prokurori i apelit ka kërkuar miratim vendimi në 15 raste dhe Gjykata e Apelit në 10 raste ka miratuar kërkesën e prokurorit, ndërsa në 5 raste ka lehtësuar pozitën duke ndryshuar llojin e masës së sigurimit, nga “Arrest në burg”, në masa me të lehta. Për tre raste duke e konsideruar vendimin e Gjykatës së Apelit në zbatim të gabuar të dispozitave procedurale parashikuar nga nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale është ushtruar rekurs nga prokurori i apelit.
 - **Për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”**, parashikuar nga neni 283/a/2 të K.Penal; janë gjykuar 10 (dhjetë) çështje masa sigurimi mbi apelin e 10 të pandehurve. Prokurori i apelit ka kërkuar miratim vendimi në 10 raste dhe Gjykata e Apelit në 8 raste ka miratuar kërkesën e prokurorit, ndërsa në 2 raste ka lehtësuar pozitën duke ndryshuar llojin e masës së sigurimit, nga “Arrest në burg”, në masa më të lehta.
 - **Për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”**, parashikuar nga neni 284/1 i K.Penal; janë gjykuar 2 (dy) çështje me objekt masa sigurimi, mbi apelin e 2 të pandehurve. Prokurori i apelit ka kërkuar për 1 (një) rast

ndryshim vendimi nga “Arrest në burg” ne një mase sigurimi me të lehtë dhe Gjykata e Apelit e ka pranuar kërkesën e prokurorit. Për çështjen tjetër prokurori i apelit ka kërkuar miratim vendimi dhe Gjykata ka disponuar me miratim vendimi.

- **Për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”,** parashikuar nga neni 284/2 i K.Penal; janë gjykuar 2 (dy) çështje me objekt masa sigurimi, mbi apelin e 2 të pandehurve. Prokurori i apelit ka kërkuar miratim vendimi në 2 raste dhe Gjykata e Apelit në 2 raste ka miratuar kërkesën e prokurorit, për mase sigurimi “Arrest në burg”.

III. Lidhur me veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, informojmë se Prokuroria e Apelit Korçë ka gjykuar 3 (tre) çështje, me 9 të pandehur,

- **Për veprën penale “Rebelim i të burgosurve”,** parashikuar nga neni 270/2 i K.Penal, ku të 7 të pandehurit janë duke vuajtur dënim për vepra penale të rënda, në I.E.V.P- Korçë. Kjo çështje ka ardhur mbi apelin e 6 të pandehurve që kanë kërkuar zbutje dënimi dhe pafajësi, Prokurori i apelit ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit ka disponuar për lënien në fuqi të vendimit.
- **Për veprën penale “Prishje e qetësisë publike”,** parashikuar nga Neni 274 i K.Penal, është gjykuar 1 (një) çështje me 1 të pandehur, me masën e sigurimit “Arrest në burg”. Çështje ka ardhur mbi apelin e të pandehurit, për zbutjen e masës së dënimit. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit për lënie në fuqi të vendimit, Gjykata e Apelit ka disponuar për lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, duke mos pranuar apelin e të pandehurit për lehtësimin e pozitës.
- **Për veprën penale “Kundërshtim i punonjësit të rendit publik”,** parashikuar nga neni 236/2 i K.Penal është gjykuar 1 (një) çështje me 1 të pandehur. Çështje ka ardhur mbi apelin e të pandehurit. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit për lënie në fuqi, Gjykata e Apelit ka disponuar për lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, duke mos pranuar apelin e të pandehurit për lehtësimin e pozitës.
- **Lidhur me çështjet e përfunduara për Masat e Sigurimit janë këto të dhëna:**
- **Lidhur me veprën penale “Kundërshtim i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik”** parashikuar nga neni 235/2 të K.Penal është gjykuar 1 (një) çështje me objekt masa sigurimi, mbi apelin e të pandehurit. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit për miratim vendimi, Gjykata e Apelit ka disponuar për miratim vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë.

IV. Lidhur me veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 të K.Penal informojmë se për periudhën analizuuese, janë gjykuar 4 (katër) çështje themeli, me 5 të pandehur, prej të cilëve 4 me masën e sigurimit “Arrest në burg”. Çështja vjen mbi apelin e të pandehurve për zbutje dënimi dhe ne 2 raste është kërkuar aplikim i nenit 59 të K.Penal. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit për lënie në fuqi, Gjykata e Apelit në një vendim me 2 të pandehur ka disponuar për ndryshimin e vendimit duke lehtësuar pozitën e të pandehurve në këtë rast. Duke e konsideruar vendimin e Gjykatës së

Apelit në zbatim të gabuar të dispozitave proceduriale parashikuar nga nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale është ushtruar rekurs nga prokurori i apelit.

- **Lidhur me veprën penale “Trafikimi i armëve dhe i municionit”** parashikuar nga neni 278/a/2 të K.Penal është gjykuar 1 (një) çështje themeli, me një të arrestuar. Çështja ka ardhur mbi apelin e të pandehurit për zbutje dënimi. Mbi kërkesën e prokurorit të apelit për lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi.
- **Lidhur me veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”**, parashikuar nga neni 278/4 të K.Penal informojmë se Prokuroria e Apelit Korçë ka gjykuar 1 (një) çështje, me apelin e të pandehurit E.E. Prokurori i apelit ka kërkuar mospranim ankimi dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me mospranim ankimi për shkak se i pandehuri ka mbaruar vuajtjen e dënimit dhe ka hequr dorë nga ankimi.
- **Lidhur me çështjet e përfunduara për Masat e Sigurimit janë këto të dhëna:**
- **Për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”**, parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal; janë gjykuar 7 (shtatë) çështje me objekt masë sigurimi, 5 mbi apelin e të pandehurit dhe 2 mbi apelin e prokurorit. Prokurori i apelit ka kërkuar miratim vendimi për 5 rast, kurse Gjykata e Apelit ka disponuar me miratim vendimi. Në 2 raste ku prokurori i apelit ka kërkuar ndryshimin e masës së sigurimit duke rënduar poziten, Gjykata e Apelit ka pranuar kërkesën e prokurorit për rëndim pozite.
- **Lidhur me veprën penale “Trafikimi i armëve dhe i municionit”** parashikuar nga neni 278/a/2 të K.Penal është gjykuar 1 (një) çështje me objekt masë sigurimi, me një të arrestuar, mbi apelin e të pandehurit. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit për miratim vendimi, Gjykata e Apelit ka disponuar për miratim vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë.
- **Lidhur me veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”**, parashikuar nga neni 278/3 të K.Penal informojmë se Prokuroria e Apelit Korçë ka gjykuar 3 (tre) çështje, 2 mbi apelin e të pandehurve dhe 1 mbi apelin e prokurorit. Prokurori i apelit ka kërkuar miratim vendimi për 2 raste dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me miratim vendimi. Në 1 rast, është vendosur mospranim ankimi për shkak të heqjes dore nga apeli i prokurorit.
- **Lidhur me veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”**, parashikuar nga neni 278/2 të K.Penal informojmë se Prokuroria e Apelit Korçë ka gjykuar 3 (tre) çështje, të treja mbi apelin e prokurorit. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur ankim prokurori i çështjes duke kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës përsa i përket disponimit që lidhet me shpalljen e moskompetencës tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, me arsyetimin se gjykata në fazën e hetimeve paraprake nuk ka juridiksion për të disponuar mbi çështjet e kompetencës. Në lidhje me këtë çështje, prokurori i apelit hoqi dorë nga apeli i prokurorit me arsyetimin se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec është i drejtë

lidhur me shpalljen e moskompetencës tokësore dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këto kushte, Gjykata e Apelit ka disponuar me mospranim ankimi.

- **Për veprën penale “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”**, parashikuar nga neni 279/2 të K.Penal, janë gjykuar 2 (dy) çështje me objekt masë sigurimi, mbi apelin e të pandehurve. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit për miratim vendimi, Gjykata e Apelit ka disponuar për miratim vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë.

V. Lidhur me veprat penale kundër krimin të organizuar informojmë se për periudhën përkatëse, është gjykuar 1 (një) çështje me objekt caktim masë sigurimi për qëllime ekstradimi, në ngarkim të shtetasit nën hetim S.R, kërkuar nga Autoritetet e Drejtësisë Sllovene, akuzuar për vepra penale të fshehjes së të ardhurave (neni 180 të K.Penal të R.SH). Çështja ka ardhur mbi apelin e shtetasit nën hetim për zbutje të llojit të masës së sigurimit. Prokurori i apelit ka kërkuar miratim vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec dhe Gjykata e Apelit ka miratuar vendimin për masën e sigurimit “Arrest në burg”.

VI. Lidhur me veprat penale “Krime seksuale”, kundër lirisë së personit dhe kundër fëmijëve dhe familjes, informojmë se për periudhën Janar - Dhjetor 2020, janë gjykuar çështjet e mëposhtme, sipas neneve përkatëse të K.Penal.

- **Për veprën penale “Vepra të turpshme”**, e parashikuar nga neni 108/3 i K.Penal, është gjykuar 1 (një) çështje themeli mbi apelin e të pandehurit, i cili ka kërkuar zbutje dënimi. Prokurori i apelit ka kërkuar lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi të vendimit.
- **Për veprën penale “Vepra të turpshme”**, e parashikuar nga neni 108/a/1 i K.Penal, është gjykuar 1 (një) çështje themeli mbi apelin e të pandehurit, i cili ka kërkuar zbutje dënimi. Prokurori i apelit ka kërkuar lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi të vendimit.
- **Për veprën penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me përsona të pazotë për t’u mbrojtur”** e parashikuar nga neni 103/1 i K.Penal, është gjykuar 1 (një) çështje themeli, mbi apelin e prokurorit për ndryshim kualifikimi. Pavarësisht kërkesës se prokurorit të apelit për rendim pozite, Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.
- **Për veprën penale “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”** e parashikuar nga neni 109/b/1 i K.Penal, është gjykuar 1 (një) çështje themeli, me dy të pandehur, të arrestuar. Çështja ka ardhur mbi apelin e të pandehurve dhe prokurori i apelit dhe Gjykata ka disponuar me mospranim ankimi, pasi bazuar në nenin 420 pika 1 germa “d”, parashikohet rasti kur Gjykata e Apelit vendos mospranimin e ankimit kur “ankimi nuk ka me objekt”, mbasi i pandehuri ka mbaruar vuajtjen e dënimit.
- **Për veprën penale “Keqtrajtimi i të miturit”**, e parashikuar nga neni 124/b/1 i K.Penal, Prokuroria e Apelit Korçë ka gjykuar 1 (një) çështje themeli, me 1 të

pandehur me masë sigurimi “Arrest në burg”. Për këtë rast ka bërë apel i pandehuri dhe ne seancq gjyqësore është kërkuar nga vetë i pandehuri heqje dorë nga ankimi për shkak se ka mbaruar vuajtjen e dënimit të dhënë nga gjykata. Në këto kushte, prokurori i apelit ka kërkuar mospranim ankimi sepse çështja ka mbetur pa objekt dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me mospranim ankimi.

- **Për veprën penale “Përndjekja”,** e parashikuar nga neni 121/a/2 i K.Penal, Prokuroria e Apelit Korçë ka gjykuar 1 (një) çështje themeli, me 1 të pandehur me masë sigurimi “Arrest në burg”. Për këtë rast ka bërë apel i pandehuri dhe ne seancq gjyqësore është kërkuar nga vetë i pandehuri heqje dorë nga ankimi për shkak se ka mbaruar vuajtjen e dënimit të dhënë nga gjykata. Në këto kushte, prokurori i apelit ka kërkuar mospranim ankimi sepse çështja ka mbetur pa objekt dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me mospranim ankimi.

- **Lidhur me çështjet e përfunduara për Masat e Sigurimit janë këto të dhëna:**

- **Për veprën penale “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”,** parashikuar nga neni 109/1 i K.Penal, është gjykuar 1 (një) çështje, me 1 të pandehur, i cili ka apeluar për ndryshim lloji të masës së sigurimit. Prokurori i Apelit ka kërkuar miratim vendimi “Arrest në burg”, Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin, duke pranuar kërkesën e prokurorit.
- **Për veprën penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”,** parashikuar nga neni 100/1 i K.Penal, është gjykuar 1 (një) çështje, me 1 të pandehur, i cili ka apeluar për ndryshim lloji të masës së sigurimit. Prokurori i Apelit ka kërkuar miratim vendimi “Arrest në burg”, Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin, duke pranuar kërkesën e prokurorit.
- **Për veprën penale “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”,** parashikuar nga neni 109/b i K.Penal, është gjykuar 1 (një) çështje, me 1 të pandehur, i cili ka apeluar për ndryshim lloji të masës së sigurimit. Prokurori i Apelit ka kërkuar miratim vendimi “Arrest në burg”, Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin, duke pranuar kërkesën e prokurorit.
- **Për veprën penale “Heqja e paligjshme e lirisë”,** e parashikuar nga neni 110/a i K.Penal, është gjykuar 1 (një) çështje, mbi apelin e të pandehurit, i cili ka kërkuar ndryshimin e llojit të masës së sigurimit. Gjykata e Apelit Korçë ka disponuar me miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë duke mbështetur kërkesën e prokurorit të apelit për miratim vendimi.
- **Për veprën penale “Përndjekja”,** e parashikuar nga neni 121/a/1 i K.Penal, Prokuroria e Apelit Korçë ka gjykuar 1 (një) çështje me objekt mase sigurimi. Çështja ka ardhur mbi apelin e të pandehurit i cili ka kërkuar ndryshimin e llojit të masës së sigurimit. Gjykata e Apelit Korçë ka disponuar me miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë duke mbështetur kërkesën e prokurorit të apelit për miratim vendimi.

VII. Lidhur me veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, informojmë se për periudhën Janar - Dhjetor 2020, janë gjykuar 13 (trembëdhjetë) çështje themeli, me 16 të pandehur.

- **Për veprën penale “*Dhuna në familje*”,** parashikuar nga neni 130/a/3 i K.Penal, janë gjykuar 3 (tre) çështje themeli, me 4 të pandehur, 3 prej tyre me masë sigurimi “Arrest në burg”. Çështjet janë gjykuar mbi apelin e të pandehurve. Në 2 rast, prokurori i apelit ka kërkuar lënien në fuqi të vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe në 1 raste ka kërkuar mospranim akimi, për shkak të heqjes dorë nga i pandehuri. Gjykata e Apelit Korçë ka disponuar me lënie në fuqi ne 2 rast dhe në 1 raste ka disponuar me mospranim ankimi.
- **Për veprën penale “*Dhuna në familje*”,** parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal, Prokuroria e Apelit Korçë ka gjykuar 5 (pesë) çështje themeli, me 7 të pandehur, 4 prej tyre me “Arrest në burg”. Çështjet janë gjykuar mbi apelin e 6 të pandehurve që kanë kërkuar zbutjen e dënimit dhe 3 raste në seancë gjyqësore nga të pandehurit është kërkuar heqje dore nga ankimi dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me mospranim ankimi. Prokurori i apelit në 2 raste ka kërkuar lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe në këto raste Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi, duke mbështetur kërkesën e prokurorit.
- **Për veprën penale “*Dhuna në familje*”,** parashikuar nga neni 130/a/4 i K.Penal, janë gjykuar 5 (pesë) çështje themeli, me 5 të pandehur, me masë sigurimi “Arrest në burg”. Çështjet janë gjykuar mbi apelin e të pandehurve. Në 2 raste, prokurori i apelit ka kërkuar lënien në fuqi të vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe në 3 raste ka kërkuar mospranim akimi, për shkak të heqjes dorë nga i pandehuri. Gjykata e Apelit Korçë ka disponuar me lënie në fuqi ne 1 rast, për 3 raste ka disponuar me mospranim ankimi dhe në 1 rast ka disponuar me lehtësim të pozitës të të dënuarit, duke ulur masën e dënimit.
- **Lidhur me çështjet e përfunduara për Masat e Sigurimit janë këto të dhëna:**
 - **Për veprën penale “*Dhuna në familje*”,** parashikuar nga neni 130/a/3, janë gjykuar 2 (dy) çështje mbi apelin e të pandehurit për zbutje të llojit të masës së sigurimit. Prokurori i apelit ka kërkuar miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe Gjykata e Apelit e ka mbështetur kërkesën e prokurorit duke disponuar me miratim vendimi.
 - **Për veprën penale “*Dhuna në familje*”,** parashikuar nga neni 130/a/4, janë gjykuar 6 (gjashtë) çështje masa sigurimi, 5 mbi apelin e të pandehurve dhe 1 mbi apelin e prokurorit kundër vendimit të Gjykatës për masë më të butë sigurimi. Prokurori i apelit ka kërkuar miratimin e vendimit për 5 raste dhe Gjykata e Apelit ka mbështetur në të 5 raste kërkesën e prokurorit të apelit për miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë/Pogradec dhe në 1 rast ka disponuar me mospranim ankimi, pasi prokurori e apelit deklaroi heqjen dorë nga ankimi i paraqitur në Gjykatën e Apelit, për shkak se e gjen të bazuar në ligj e në prova vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.
 - **Për veprën penale “*Dhuna në familje*”,** parashikuar nga neni 130/a/1 të K.Penal janë gjykuar 9 (nëntë) çështje masa sigurimi, të ardhura për

grykim mbi apelin e të pandehurve për zbutje të llojit të masës së sigurimit. Në të 9 raste prokurori i apeli ka kërkuar miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit ka disponuar për 9 raste me miratimin e vendimit duke mbështetur kërkesën e prokurorit të apelit.

VIII. Lidhur me veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit, informojmë se për periudhën Janar - Dhjetor 2020, janë gjykuar çështjet e mëposhtme, sipas neneve përkatëse të K.Penal.

- **Për veprën penale “Prostitucioni”**, e parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal, Prokuroria e Apelit Korçë ka gjykuar 1 (një) çështje themeli me 1 të pandehur. Për këtë rast ka bërë apel i pandehuri duke kërkuar zbutje të masës së dënimit për veprën e kryer. Prokurori i apelit ka kërkuar mospranim ankimi dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me mospranim ankimi.
- **Lidhur me çështjet e përfunduara për Masat e Sigurimit janë këto të dhëna:**
- **Lidhur me veprën penale “Shfrytëzimi i prostitucionit”**, e parashikuar nga neni 114/2 i K.Penal është gjykuar 1 (një) çështje me objekt mase sigurimi, me një të arrestuar, mbi apelin e të pandehurit. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit për miratim vendimi, Gjykata e Apelit ka disponuar për miratim vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë.

IX. Lidhur me veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë; informojmë se për periudhën Janar - Dhjetor 2020, janë gjykuar 2 (dy) çështje themeli, me 6 të pandehur.

- **Për veprën penale “Ndhurma për kalim të paligjshëm të kufirit”**, parashikuar nga neni 298/3 i K.Penal, janë gjykuar 2 (dy) çështje themeli, me 6 të pandehur, 4 prej tyre me masë sigurimi “Arrest në burg” dhe 2 prej tyre me masë sigurimi “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Çështjet janë gjykuar mbi apelin e të pandehurve. Në 6 rast, prokurori i apelit ka kërkuar lënien në fuqi të vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë. Gjykata e Apelit Korçë ka disponuar me lënie në fuqi në 3 rast dhe në 3 raste ka disponuar me lehtësim të pozitës të të dënuarit, duke ulur masën e dënimit.
- **Lidhur me masat e sigurimit të gjykuara në Prokurorinë e Apelit Korçë, për veprat penale të “Ndhurma për kalim të paligjshëm të kufirit”, rezulton se për periudhën kohore të kërkuar janë gjykuar 129 (njëqind e njëzet e nentë) çështje ku:**
- **Për veprën penale “Ndhurma për kalim të paligjshëm të kufijve”**, e parashikuar nga neni 298/3 i K.Penal, Prokuroria e Apelit Korçë ka gjykuar 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) çështje me objekt mase sigurimi. Çështjet kanë ardhur 114 mbi apelin e të pandehurve, të cilët kanë kërkuar ndryshimin e llojit të masës së sigurimit, Gjykata e Apelit ka vendosur mospranim ankimi në 2 raste dhe 1 çështje ka erdhur mbi apelin e prokurorit. Për 6 raste prokurori i apelit ka kërkuar lehtësimin e pozitës të të pandehurve, nga arrest në burg në një mase me të butë sigurimi dhe Gjykata e Apelit ka pranuar kërkesën e prokurorit për lehtësim pozite në 5 raste dhe një rast

prokurori i apelit ka kërkuar rëndimin e pozitës të të pandehurit dhe Gjykata e Apelit ka vendosur miratimin e vendimit. Prokurori i apelit ka kërkuar miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për 107 raste dhe në 73 raste Gjykata e Apelit ka disponuar me pranimin e kërkesës se prokurorit duke vendosur miratim vendimi, ndersa ne 34 raste Gjykata e Apelit Korçë ka disponuar me ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë nga masa e sigurimit “Arrest në burg” në një masë me të lehtë sigurimi “Arrest në shtëpi” dhe “Garanci pasurore”. Për 6 (gjashtë) raste duke e konsideruar vendimin e Gjykatës së Apelit në zbatim të gabuar të dispozitave proceduriale parashikuar nga nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale, është ushtruar rekurs nga prokurori i apelit.

- **Për veprën penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”,** e parashikuar nga neni 298/2 i K.Penal, Prokuroria e Apelit Korçë ka gjykuar 14 (katërmëdhjetë) çështje me objekt masë sigurimi. Çështjet kanë ardhur mbi apelin e të pandehurve, të cilët kanë kërkuar ndryshimin e llojit të masës së sigurimit. Për 1 rast prokurori i apelit ka kërkuar lehtësimin e pozitës të të pandehurit, nga “Arrest në burg” në një masë më të butë sigurimi dhe Gjykata e Apelit ka pranuar kërkesën e prokurorit për lehtësim pozite. Në 13 raste, prokurori i apelit ka kërkuar miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe në 10 raste Gjykata e Apelit ka disponuar me pranimin e kërkesës se prokurorit duke vendosur miratim vendimi, ndërsa në 3 rast Gjykata e Apelit Korçë ka disponuar me ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë nga masa e sigurimit “Arrest në burg” ne një mase me të butë sigurimi. Duke e konsideruar vendimin e Gjykatës së Apelit në zbatim të gabuar të dispozitave proceduriale parashikuar nga nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale, për 2 rast është ushtruar rekurs nga prokurori i apelit.

X. Lidhur me veprën penale “Kontrabandë nga punonjësit qe lidhen me veprimtarinë doganore”, parashikuar nga neni 175 i K.Penal, Prokuroria e Apelit Korçë ka gjykuar 1 (një) çështje me objekt mase sigurimi. Çështja ka ardhur mbi apelin e prokurorit i cili ka kërkuar ndryshimin e llojit të masës së sigurimit, duke rënduar pozitën e të pandehurit, Gjykata e Apelit ka pranuar kërkesën e prokurorit për rëndim pozite.

XI. Lidhur me veprat penale kundër krimit të pasurisë informojmë se për periudhën Janar - Dhjetor 2020, janë gjykuar 14 (katërmëdhjetë) çështje themeli, me 29 të pandehur, prej të cilëve 20 të arrestuar.

- **Për veprën penale “Vjedhja”,** parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, janë gjykuar 5 (pesë) çështje themeli, me 7 të pandehur, 4 prej tyre me masë sigurimi. Çështjet janë gjykuar mbi apelin e të pandehurve. Gjykata e Apelit ka vendosur mospranimin e ankimit për 2 çështje. Në 3 raste prokurori i apelit ka kërkuar lënien në fuqi të vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit Korçë ka disponuar për pranimin e kërkesës të prokurorit të Apelit.
- **Për veprën penale “Vjedhja”,** parashikuar nga neni 134/2 i K.Penal, janë gjykuar 7 (shtatë) çështje themeli, me 17 të pandehur, 13 prej tyre me masë sigurimi. Çështjet janë gjykuar mbi apelin e të pandehurve. Gjykata e Apelit ka vendosur mospranimin e ankimit për 2 raste. Në 5 raste prokurori i apelit ka

kërkuar lënien në fuqi të vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit Korçë ka disponuar për pranimin e kërkesës të prokurorit të Apelit.

- **Për veprën penale “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”,** parashikuar nga neni 135 i K.Penal, është gjykuar 1 (një) çështje themeli, me 1 të pandehur, mbi apelin e të pandehurit. Prokurori i apelit ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë duke lehtësuar pozitën e të pandehurit dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me pranimin e kërkesës të prokurorit të Apelit.
- **Për veprën penale “Vjedhja me dhunë”,** parashikuar nga neni 139 i K.Penal, është gjykuar 1 (një) çështje themeli, me 4 të pandehur, 3 prej tyre me masë sigurimi. Çështja është gjykuar mbi apelin e të pandehurve. Prokurori i apelit ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit Korçë ka disponuar për pranimin e kërkesës.

- **Lidhur me çështjet e përfunduara për Masat e Sigurimit janë këto të dhëna:**

- **Për veprën penale “Vjedhja”,** parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal, janë gjykuar 4 (katër) çështje me objekt mase sigurimi, me 4 të pandehur, mbi apelin e të pandehurve dhe 1 mbi ankimin e prokurorit. Prokurori i Apelit ka kërkuar miratimin e vendimit për 2 raste dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me miratim vendimi. Në 1 rast është vendosur mospranim ankimi për shkak të heqjes dorë nga apeli i prokurorit. Në një rast prokurori i Apelit ka kërkuar ndryshimin e vendimit në një mase sigurimi më të butë dhe Gjykata e Apelit ka pranuar kërkesën e prokurorit.
 - **Për veprën penale “Vjedhja”,** parashikuar nga neni 134/2 i K.Penal, janë gjykuar 3 (tre) çështje me objekt mase sigurimi, me 3 të pandehur, mbi apelin e të pandehurve. Prokurori i Apelit ka kërkuar miratimin e vendimit dhe Gjykata e Apelit e ka mbështetur kërkesën e prokurorit duke disponuar me miratim vendimi.
 - **Për veprën penale “Vjedhja me dhunë”,** parashikuar nga neni 139 i K.Penal, janë gjykuar 10 (dhjetë) çështje me objekt mase sigurimi, me 10 të pandehur, mbi apelin e të pandehurve. Gjykata e Apelit ka vendosur mospranimin e ankimit për 2 çështje. Në 8 raste prokurori i Apelit ka kërkuar miratimin e vendimit dhe Gjykata e Apelit ka mbështetur kërkesën e prokurorit duke disponuar me miratim vendimi.
- Në analizën e periudhës Janar - Dhjetor 2020, vepra penale më dominuese ka qënë “*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*”, e parashikuar nga neni 298 i K.Penal. Kjo vepër po gjen përhapje të madhe në rrethin e Korçës dhe Pogradecit, për shkak të fluksit të madh të klandestinëve që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë jashtë pikave të kufirit në mënyrë të paligjshme dhe që nuk disponojnë dokumentat për lejë qëndrimi dhe që kanë si qëllim destinacionin në BE. Për këto raste, prokurori i apelit ka mbajtur qëndrim të ashpër duke kërkuar si masë sigurimi atë të “Arrest në burg”, por Gjykata e Apelit ka ndryshuar masën e sigurimit duke dhënë masa sigurimi më të buta nga ajo e vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë.

- Gjykata e Apelit Korçë në disa prej çështjeve ku ka ndryshuar masën e sigurimit nga “Arrest në burg” në një masë më të butë, ka mbajtur në konsideratë udhëzimet e Ministrit të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me masat e sigurimit dhe alternativat e ekzekutimit të dënimit me burgim që duhen caktuar, të kushtëzuara nga gjëndja e pandemisë dhe të masave mbrojtëse ndaj përhapjes së virusit Covid 19, ruajtjen e një balance të drejtë ndërmjet të drejtës për jetë dhe shëndet të të paraburgosurit dhe personelit të institucioneve të vuajtjes së dënimit. Për këto raste, edhe për arsye të rrezikshmërisë së pakët të personave të arrestuar, është parë e arsyeshme nga ana jonë që të mos ushtrohet rekurs.
- Referuar të dhënave statistikore, vihet re tendenca në rritje e zbutjes së masës së sigurimit nga ana e Gjykatës së Apelit, pavarësisht plotësimit të kushteve të shtetasve nën hetim për të qëndruar në masë me karakter shtrëngues. Nevojat e sigurimit, shkalla e rëndësisë së të cilave përcakton edhe llojin e masës së sigurimit diktohen nga një sërë elementësh të tillë si: rreziku i ikjes së personit nën hetim ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit, rreziku i ndikimit në marrjen ose vërtetësinë e provave gjatë fazës së hetimit ose rreziku i vazhdimësisë së veprimtarisë kriminale. Nga ana tjetër është organi i akuzës, i cili rast pas rasti duhet të provojë para gjykatës ekzistencën e kritereve të veçanta që kërkon dispozita e nenit 230 të K.Pr.Penale për caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” si një masë ekstreme dhe që duhet të vendoset “vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme.” Në bazë të nenit 237 të K.Pr.Penale, masa shtrënguese e “Arrestit në shtëpi” si masë që privon lirinë e personit, zë vëndin e dytë në shkallën graduale të masave shtrënguese personale, pas asaj të paraburgimit, nisur nga shkalla dhe ndikimi që ajo ka në lirinë personale të personit të prekur, por nga natyra ajo njësohet me masën e paraburgimit. “Arresti në shtëpi” është një masë shtrëngimi që paraqet një sërë të përbashkëtash me masën e sigurimit personal të “arrestit në burg”.
- Po ashtu, përveç masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, në shumicën e rasteve të ndryshuara është caktuar nga ana e Gjykatës së Apelit masa e sigurimit “Garanci pasurore”, parashikuar nga neni 236/1 i K.Pr.Penale, masë e cila kushtëzon zëvendësimin e masës arrest në burg ose në shtëpi, vetëm për shkak të ekzistencës së rrezikut të ikjes. Gjithsesi kostatohen raste ku Gjykata e Apelit ka zëvendësuar arrestin në burg me garanci pasurore edhe pse kanë ekzistuar shkaqe të tjera të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provave, apo rreziku i përsëritjes së veprës penale. Këto raste janë bërë objekt rekursi për zbatim të gabuar të ligjit.
- Rol të rëndësishëm në ushtrimin e funksionit të Prokurorisë së Apelit në luftën kundër krimit ka bashkëpunimi me institucionet: I.E.V.P-Korçë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë/Pogradec, Policinë Gjyqësore dhe Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës, të cilët ndjekin ekzekutimin e vendimeve. Bashkëpunimi me këto institucione është korrekt dhe në zbatim të ligjit. Nga ana e prokurorisë, për natyrën e veprimtarisë së saj, ka një bashkëpunim mjaft të mirë e korrekt me Prokuroritë e Rrethit Gjyqësor dhe Policinë Gjyqësore pranë saj. Ky bashkëpunim është i domosdoshëm për një zgjidhje të drejtë dhe ligjore gjatë gjyqimit të çështjes në Gjykatën e Apelit. Kjo kushtëzon një komunikim permanent në marrjen e akteve të ndryshme, fashikullit të prokurorit, marrjen e provave shtesë kur çelet shqyrtimi gjyqësor, apo edhe

për fazën e ekzekutimit. Në çdo moment, Prokuroria e Apelit Korçë, vë në dijeni Prokurorinë e Rrethit (drejtuesin apo dhe prokurorin e çështjes) për mënyrën e përfundimit të çështjeve, sidomos ato të ndjekura mbi apelin e prokurorit. Mbarëvajtja e veprimtarisë së Prokurorisë së Apelit lidhet edhe me një bashkëpunim të mirë me Gjykatën e Apelit, sidomos për momentin e marrjes së dosjes për studim apo venies në dispozicion të prokuroreve, shkurtimeve e vendimit për momentin e ekzekutimit të menjëhershëm.

- Në Prokurorinë e Apelit Korçë, gjatë periudhës Janar-Shtator 2020 janë përmbushur të gjitha shpenzimet e parapërcaktuara në projekt-buxhetin e vitit 2020, që përfshijnë zërat: paga, sigurime shoqërore dhe shpenzimet operative. Konstatohet bashkëpunim efektiv me Drejtorinë Ekonomike pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Disiplina në punë shihet si një element që ndikon në veprimtarinë e Prokurorisë së Apelit Korçë, e cila respektohet nga të gjithë punonjësit. Po kështu, Kodi i Etikës dhe rregullat e vendosura prej tij, janë në vëmendje të prokuroreve dhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë dhe respektohen maksimalisht.
- Për vitin 2020 është parë si objektiv kryesor rritja e nivelit të përfaqësimit të akuzës në apel dhe ndjekja me përparësi e çështjeve në luftën kundër kriminalitetit, në zbatim të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, Rezolutës së Kuvendit dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj, si dhe të urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Në zbatim të planit të veprimit Prokuroria e Apelit Korçë, në vazhdimësi ka marrë masat e nevojshme për plotësimin dhe sigurimin e kushteve teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale. Prokuroria e Apelit Korçë ka krijuar “Rregullore” për përcaktimin e rregullave për aktet administrative dhe qarkullimi i tyre në institucion. Stafi i prokurorisë zbaton me korrektësi rregulloren e brendshme, po ashtu dhe Raportin Monitorues të Komisionerit “Për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të Dhënave Personale”, rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Prokurori”, miratuar me Urdhërin nr. 140, datë 03.09.2019, të Prokurorit të Përgjithshëm, Ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.
- Në Prokurorinë e Apelit Korçë, gjatë vitit 2020 janë përmbushur të gjitha shpenzimet e paracaktuara në projekt-buxhetin e vitit 2020, që përfshijnë zërat: paga, sigurime shoqërore dhe shpenzimet operative. Korrektësia dhe disiplina financiare kanë qënë në nivel shumë të lartë në mënyrën e administrimit sa më eficient të shpenzimeve. Konstatohet bashkëpunim efektiv me Drejtorinë Ekonomike pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Disiplina në punë shihet si një element që ndikon në veprimtarinë e Prokurorisë së Apelit Korçë, e cila respektohet nga të gjithë punonjësit. Po kështu, Kodi i Etikës dhe rregullat e vendosura prej tij, janë në vëmendje të prokuroreve dhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë dhe respektohen maksimalisht.
- Prokuroria e Apelit Korçë me juridiksion të përgjithshëm ka një bashkëpunim korrekt dhe ligjor me institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme, duke informuar në mënyrë periodike për zbatimin e rekomandimeve në mbështetje

edhe të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm për luftën kundër kriminalitetit.

- Gjithashtu është forcuar bashkëpunimi me Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Korçë/Pogradec, me juridiksion të përgjithshëm si një faktor i domosdoshëm për një zgjidhje të drejtë dhe ligjore të çështjes në Gjykatën e Apelit. Kjo kushtëzon një komunikim permanent në marrjen e akteve të ndryshme, fashikullit të prokurorit, marrjen e provave shtesë kur përsëritet shqyrtimi gjyqësor, apo edhe për fazën e ekzekutimit. Në çdo moment, Prokuroria e Apelit Korçë vë në dijeni Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë (*prokurorin e çështjes*) për mënyrën e përfundimit të çështjeve, sidomos ato të ndjekura mbi apelin e prokurorit.
- Mbarëvajtja e veprimtarisë së Prokurorisë së Apelit Korçë lidhet me një bashkëpunim korrekt dhe në zbatim të ligjit me Gjykatën e Apelit, me strukturat e Policisë së Shtetit dhe Policisë Gjyqësore, me I.E.V.P-Korçë dhe Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës, për fazën e ekzekutimit të vendimeve, si dhe me institucione të tjera ligjzbatuese, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore të Prokurorisë së Apelit.
- Për vitin 2021 shihet si objektiv kryesor rritja e nivelit të përfaqësimit të akuzës në apel dhe ndjekja me përparësi e çështjeve në luftën kundër kriminalitetit, në zbatim të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, Rezolutës së Kuvendit dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj, si dhe të urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.

Duke ju falenderuar!

DREJTUESE E PROKURORISË

Ollga VISI

**ME POROSI DHE AUTORIZIM
PROKURORE
IRENA ÇUNOTI**

